

---

## THE ROLE OF INTERNATIONAL ACTORS IN THE PRESERVATION OR FAILURE OF PEACE IN THE MIDDLE EAST: A CASE ANALYSIS OF THE PALESTINE-IZRAEL CONFLICT

**Qazime Sherifi**

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia, [qazime.sherifi@unt.edu.mk](mailto:qazime.sherifi@unt.edu.mk)

**Abstract:** This paper critically analyzes the complex role of international actors in either preserving or undermining peace in the Middle East, with a particular focus on the Israeli–Palestinian conflict. The analysis centers on how major powers (the United States, the European Union, Russia), international organizations (the United Nations), and Arab states have contributed to the dynamics of the conflict—either exacerbating it or marginally fostering the prospects for a just and sustainable peace. Through a review of contemporary literature and official documents, the paper highlights the ongoing tension between political rhetoric and realpolitik, as well as the double standards that characterize international intervention in this conflict. The findings show that the lack of an impartial approach toward the actors involved, diplomacy driven by strategic interests, and the failure to implement international law have severely undermined the legitimacy of the international order. The case of Palestine is treated as a symptom of the broader crisis of multilateralism and as a test case for the international community's capacity to uphold the principles of global justice, human rights, and self-determination. In conclusion, the paper emphasizes the need for a profound reform of the international peace and security architecture in order to create genuine conditions for a fair and inclusive resolution to the Palestinian issue.

**Keywords:** Palestine, Izrael, Middle East, international diplomacy, peace, USA, EU, RUSSIA, UN, Arab States double standards,

## ROLI I AKTORËVE NDËRKOMBËTARË NË RUAJTJEN OSE DËSHTIMIN E PAQES NË LINDJEN E MESME: ANALIZË E RASTIT TË KONFLITIT PALESTINË-IZRAEL

**Qazime Sherifi**

Universiteti Nënë Tereza, Republika e Maqedonisë së Veriut, [qazime.sherifi@unt.edu.mk](mailto:qazime.sherifi@unt.edu.mk)

**Abstrakt:** Ky punim analizon në mënyrë kritike rolin kompleks të aktorëve ndërkombëtarë në ruajtjen ose dështimin e paqes në Lindjen e Mesme, me fokus të veçantë në konfliktin izraelito-palestinez. Analiza përqendrohet në mënyrën se si fuqitë e mëdha (Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Rusia), organizatat ndërkombëtare (Kombet e Bashkuara) dhe shtetet arabe kanë kontribuar në dinamikën e konfliktit, duke e thelluar ose relativizuar mundësinë për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme. Përmes shqyrtimit të literaturës bashkëkohore, dokumenteve zyrtare, punimi evidenton tensionin e vazhdueshëm ndërmjet retorikës politike dhe realpolitikës, si dhe standardeve të dyfishta që karakterizojnë ndërhyrjen ndërkombëtare në këtë konflikt. Rezultatet tregojnë se mungesa e një qasjeje të barabartë ndaj aktorëve, një diplomaci e dominuar nga interesa strategjike dhe dështimi për të zbatuar të drejtën ndërkombëtare kanë minuar seriozisht legjitimitetin e rendit ndërkombëtar. Rasti i Palestinës trajtohet si simptomë e krizës më të gjerë të multilateralizmit dhe si provë testuese e aftësisë së bashkësisë ndërkombëtare për të mbrojtur parimet e drejtësisë globale, të drejtave të njeriut dhe vetëvendosjes. Në përfundim, punimi nënvizon nevojën për një reformim të thellë të arkitekturës ndërkombëtare për paqe dhe siguri, në mënyrë që të krijohen kushte reale për një zgjidhje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse të çështjes palestineze.

**Fjalëkyçe:** Palestina, Izraele, Lindja e Mesme, diplomacia ndërkombëtare, paqja, SHBA, BE, RUSIA, OKB, vendet arabe, standardet e dyfishta.

### 1. HYRJE

Konflikti izraelito-palestinez përbën një nga sfidat më të komplikuar dhe më të zgjatura në historinë bashkëkohore ndërkombëtare, duke u shtrirë në më shumë se një shekull dhe duke përfshirë dimensione të shumta politike, sociale, historike dhe kulturore. Ky konflikt jo vetëm që ka ndikuar thellësisht në stabilitetin e Lindjes së Mesme, por edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në rendin global politik. Përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme janë ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe rajonalë, të cilët kanë përdorur mjete të ndryshme diplomatike, politike, ekonomike dhe ushtarake, duke shpeshherë reflektuar interesa të ndryshme strategjike dhe prioritetet e kundërta.

Në këtë kontekst, roli i aktorëve ndërkombëtarë është vendimtar për kuptimin e dinamikave të konfliktit dhe perspektivave të paqes. Fuqitë globale si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Rusia, Organizata e Kombeve të Bashkuara, si dhe aktorët rajonalë, përfshirë shtetet arabe, kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë role të ndryshme, shpeshherë kontradiktore, në proceset negociatore dhe në zhvillimet në terren. Ndërhyrjet e tyre shpesh përkthehen në një kombinim të mbështetjes politike, ndihmave ekonomike, ndërhyrjeve diplomatike dhe presioneve ushtarake, duke krijuar një peizazh kompleks ndërkombëtar që ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e rajonit.

Megjithatë, ndërhyrjet ndërkombëtare nuk janë gjithmonë të koordinuara apo të harmonizuara, dhe shpesh përfshijnë interesa konkurruese që pengojnë avancimin e procesit të paqes. Kjo ka krijuar një situatë ku paqja mbetet e brishtë dhe e paqëndrueshme, ndërsa dhuna dhe konfliktet e përhershme vazhdojnë të ndikojnë negativisht në jetën e miliona njerëzve. Në këtë mënyrë, analiza e rolit të aktorëve ndërkombëtarë duhet të marrë parasysh jo vetëm mekanizmat zyrtarë dhe deklaratat politike, por edhe ndikimin e faktorëve të fshehtë strategjikë, ekonomiko-politikë dhe kulturorë që ndikojnë në mënyrën se si ndërhyjnë këta aktorë.

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një analizë të thelluar dhe kritike të rolit të aktorëve ndërkombëtarë në ruajtjen ose dështimin e paqes në Lindjen e Mesme, duke u fokusuar në konfliktin izraelito-palestinez. Përmes analizës së dokumenteve zyrtare, literaturës shkencore dhe rasteve konkrete të ndërhyrjeve ndërkombëtare, ky punim synon të nxjerrë në pah faktorët që kontribuojnë në vazhdimësinë e konfliktit, si dhe mundësitë e reja për ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme. Në këtë drejtim, studimi do të trajtojë ndikimet e diplomacisë ndërkombëtare, rolin e organizatave multilaterale, dhe dinamikat e marrëdhënieve bilaterale që ndikojnë në këtë konflikt, duke synuar të kontribuojë në kuptimin më të mirë të sfidave dhe perspektivave për paqen në rajon dhe më gjerë.

## **2. ROLI I AKTORËVE NDËRKOMBËTARË NË KONFLIKTIN PALESTINË-IZRAEL**

### **2.1. SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS: NDËRMJETSUES I PAANSHËM APO SPONSOR I NJËANSHËM**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë luajtur për dekada me radhë një rol vendimtar në Lindjen e Mesme, duke u përfshirë thellësisht në konfliktin izraelito-palestinez. Ndërsa në mënyrë retorike ShBA paraqitet si një ndërmjetës i paanshëm në përpjekjet për paqe, realiteti tregon një prirje të vazhdueshme drejt mbështetjes së Izraelit, qoftë në planin diplomatik, ushtarak apo financiar. Ky pozicion shpesh ka kontribuar më shumë në thellimin e konfliktit sesa në zgjidhjen e tij. Një prej elementeve më të qëndrueshme të politikës së jashtme amerikane në Lindjen e Mesme është aleanca strategjike me Izraelin. Që nga viti 1948, ShBA ka qenë sponsori më i madh ushtarak dhe politik i Izraelit. Vetëm në vitin 2016, administrata e Presidentit Barack Obama nënshkroi një marrëveshje ndihme ushtarake dhjetëvjeçare me vlerë 38 miliardë dollarë për Izraelin, që përbën paketën më të madhe të ndihmës së huaj ushtarake në historinë amerikane (Sharp, 2021). Mbështetja e pakushtëzuar për Izraelin, përfshirë mbrojtjen e tij në forumet ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, ka minuar kredibilitetin e ShBA-së si ndërmjetës paqeje në sytë e palestinezëve dhe botës arabe. Vetoja e përsëritur ndaj rezolutave që dënojnë veprimet izraelite kundër civilëve palestinezë është parë si legjitimim i dhunës strukturore dhe i politikave të okupimit.

Përkundër kësaj mbështetje, ShBA ka qenë protagoniste në një sërë përpjekjesh për arritjen e paqes, përfshirë Marrëveshjet e Oslos (1993), Samitin e Camp David (2000) dhe më vonë të ashtuquajturin “Planin e Paqes” të Presidentit Donald Trump, i njohur si “Marrëveshja e Shekullit” (2020). Megjithatë, këto nisma janë kritikuar për mungesë të balancës dhe për favorizim të pozicioneve izraelite në kurriz të aspiratave kombëtare të palestinezëve. Për shembull, “Marrëveshja e Shekullit” ofroi njohje të gjerë për kërkesat izraelite për siguri dhe sovranitet, ndërkohë që i reduktoi pretendimet palestineze për shtetësi në një strukturë të fragmentuar territorialisht dhe pa kontroll real mbi kufijtë, burimet natyrore apo sigurinë. Ky plan u refuzua unanimisht nga udhëheqësit palestinezë dhe u kritikua si një përpjekje për të imponuar një “paqe të pabarabartë” (Pappé, 2021).

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është paqëndrueshmëria e qasjes amerikane ndaj konfliktit, që ndryshon ndjeshëm varësisht nga administrata në pushtet. Administratat republikane janë shquar për mbështetje më të fortë dhe më pak kritike ndaj Izraelit, ndërsa ato demokrate kanë tentuar një balancim më të kujdesshëm, ndonëse pa ndryshuar në mënyrë rrënjësore arkitekturën e politikës së jashtme. Kjo paqëndrueshmëri e bën të vështirë arritjen e një procesi të qëndrueshëm paqeje.

Roli amerikan në këtë konflikt nuk ka ndikim vetëm në raportet palestinezo-izraelite, por ndikon edhe në marrëdhëniet më të gjera në Lindjen e Mesme. Politikat e njëanshme të ShBA-së kanë kontribuar në rritjen e tensioneve me aktorë si Irani, Turqia dhe disa vende të Gjirit, si dhe kanë nxitur ndjenja antiamerikane në mesin e popujve të rajonit. Këto dinamika e bëjnë më të ndërlikuar çdo përpjekje për ndërmjetësim paqësor të qëndrueshëm. Shtetet e Bashkuara, pavarësisht potencialit të tyre të jashtëzakonshëm për të ndikuar në paqen e Lindjes së Mesme, kanë dështuar të veprojnë si një ndërmjetës i paanshëm dhe efektiv në konfliktin Palestinë-Izrael. Mbështetja e pakushtëzuar për Izraelin, mungesa e presionit efektiv për respektimin e të drejtave të palestinezëve, si dhe politikat kontradiktore ndëradministrative, kanë kontribuar më shumë në përjetësimin e konfliktit sesa në zgjidhjen e tij. Për

një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme, roli i ShBA-së duhet të transformohet nga mbështetës i njëanshëm në garantues i të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave njerëzore.

## **2.2. BASHKIMI EVROPIAN: MES NDIKIMIT EKONOMIK DHE IMOTENCËS POLITIKE**

Bashkimi Evropian (BE) ka pretenduar të luajë një rol të rëndësishëm në politikën ndërkombëtare si një aktor i paqes, zhvillimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Megjithatë, kriza e përhershme në Lindjen e Mesme, sidomos konflikti izraelito-palestinez e ka vënë në pah hendekun mes potencialit ekonomik të BE-së dhe mungesës së ndikimit real politik në këtë çështje. Ky disbalancë midis fuqisë ekonomike dhe impotencës politike është bërë më i dukshëm gjatë viteve të fundit, kur Bashkimi Evropian, megjithë deklaratat dhe ndihmat financiare, ka dështuar të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme mbi palët ndërluftuese dhe mbi zhvillimet në terren.

Në aspektin ekonomik, BE-ja është një nga donatorët më të mëdhenj të ndihmës humanitare dhe zhvillimore për popullin palestinez. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, vetëm gjatë periudhës 2021–2024, BE ka kontribuar me më shumë se 1.15 miliardë euro për autoritetet Palestineze dhe për agjencitë ndërkombëtare që operojnë në Gaza dhe Bregun Perëndimor (European Commission, 2024). Kjo përfshin ndihma për sistemin shëndetësor, arsimor, ndihma emergjente gjatë krizave, si dhe mbështetje për refugjatët palestinezë. Ky angazhim financiar është një dëshmi e përkushtimit të deklaruar të BE-së për një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme të konfliktit. Por, në planin politik, BE shpesh ka mbetur një aktor periferik, pa kapacitet vendimmarrës në procesin e paqes. Ndërsa Shtetet e Bashkuara kanë monopolizuar rolin ndërmjetësues në negociatat izraelito-palestineze, Bashkimi Evropian është reduktuar në rolin e një vëzhguesi aktiv, por pa instrumente të detyrueshme politike. Për më tepër, ndarjet e brendshme midis shteteve anëtare të BE-së mbi çështjen e Lindjes së Mesme kanë penguar ndërtimin e një qëndrimi të përbashkët strategjik. Ndërkohë që disa vende si Suedia apo Irlanda kanë mbështetur në mënyrë të hapur shtetësinë palestineze, të tjera si Gjermania apo Hungaria kanë mbajtur qëndrime më të afërta me Izraelin, duke e bërë të pamundur një linjë të unifikuar veprimi. Në këtë kontekst, BE-ja ka shpallur vazhdimisht mbështetjen për zgjidhjen me dy shtete dhe respektimin e së drejtës ndërkombëtare, por mungesa e presionit konkret mbi Izraelin ka dobësuar besueshmërinë e saj. Për shembull, edhe pse Bashkimi Evropian e konsideron vendbanimet izraelite në territoret palestineze si të paligjshme, ai nuk ka vendosur sanksione apo masa ndëshkuese kundër qeverisë izraelite, duke e reduktuar reagimin e tij në deklarata simbolike. Në të njëjtën kohë, marrëveshjet e tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik midis BE-së dhe Izraelit kanë vazhduar, madje janë zgjeruar, pavarësisht nga përshkallëzimi i dhunës dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut në Gaza.

Konflikti i vitit 2023–2024 e thelloi më tej këtë paradoks. Pavarësisht brutalitetit të operacioneve ushtarake izraelite në Gaza, BE-ja nuk arriti të adoptojë një qëndrim të përbashkët as për ndalimin e eksportit të armëve drejt Izraelit, as për të ndërmarrë veprime konkrete në mbrojtje të civilëve palestinezë. Në vend të kësaj, përgjigjet u fragmentuan mes thirrjeve për ndalim të armiqësive dhe apelimit për respektimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare, pa pasoja reale në terren. Kjo situatë vë në pikëpyetje vetë narrativën e Bashkimit Evropian si një "fuqi normative" në arenën ndërkombëtare. Nëse BE-ja synon të ruajë këtë status, ajo duhet të tejkalojë pasivitetin diplomatik dhe të përdorë instrumentet që ka në dispozicion – si fuqia e tregut, sanksionet, dhe diplomacia shumëpalëshe – për të ndikuar realisht mbi aktorët që shkaktojnë ose përkeqësojnë konfliktin. Në të kundërt, roli i saj do të mbetet simbolik dhe i kufizuar në dimensionin humanitar, pa ndonjë ndikim politik të matshëm.

Në përfundim, mund të thuhet se Bashkimi Evropian është kapur në një kontradiktë të thellë: ai zotëron burimet për të qenë një aktor i rëndësishëm në Lindjen e Mesme, por i mungon vullneti politik dhe kohezioni i brendshëm për të ushtruar këtë rol. Derisa të tejkalohen këto barrierë, BE-ja do të vazhdojë të jetë një "gjigant ekonomik dhe një xhuxh politik", siç është përshkruar shpesh në analizat kritike të politikës së jashtme evropiane.

## **2.3. RUSIA: NJË FUQI TRADICIONALE ME ROL STRATEGJIK DHE SIMBOLIK**

Rusia, si pasuese e Bashkimit Sovjetik, ka luajtur një rol të veçantë dhe kompleks në konfliktin izraelito-palestinez, duke alternuar mes mbështetjes për të drejtat palestineze dhe ruajtjes së marrëdhënieve strategjike me Izraelin. Ky pozicion dykuptimësh është formësuar nga interesat gjeopolitike të Moskës në Lindjen e Mesme, historia e gjatë e lidhjeve me botën arabe dhe ambicia për të sfiduar dominimin perëndimor në çështjet ndërkombëtare, sidomos në një kontekst ku rendi global po shfaq shenja krize dhe fragmentimi. Bashkimi Sovjetik ishte ndër të parët që njohu shtetin e Izraelit në vitin 1948, por më vonë u pozicionua fuqimisht në mbështetje të kauzës palestineze, sidomos gjatë Luftës së Ftohtë, si pjesë e rivalitetit ideologjik dhe strategjik me SHBA-në në rajon. BRSS furnizoi me armë dhe mbështetje politike shtetet arabe dhe u bë një nga mbrojtësit kryesorë të të drejtës së popullit palestinez për vetëvendosje (Golan, 1990). Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, Rusia trashëgoi këtë trashëgimi historike, por e transformoi qasjen e saj në përputhje me interesat e një shteti që kërkon stabilitet dhe rikthim të influencës në Lindjen e Mesme. Në periudhën post-sovjetike, Rusia e ka ripozicionuar veten si një aktor ndërkombëtar që mban kontakte të balancuara me të dyja palët në konflikt: ajo ka ruajtur lidhje tradicionale me autoritetet palestineze dhe grupe si Hamas, por njëkohësisht ka forcuar marrëdhëniet politike, ekonomike dhe ushtarake me Izraelin

(Kozhanov, 2016). Kjo politikë e dyfishtë i mundëson Ruisë të shfaqet si ndërmjetësues i mundshëm dhe alternativ ndaj dominimit amerikan në procesin e paqes.

Gjatë dekadës së fundit, Rusia ka shtuar përpjekjet për të ofruar një platformë alternative për negociatat palestinezo-izraelite. Moska ka organizuar takime me përfaqësues të të dyja palëve dhe ka shprehur gatishmëri për të ndërmjetësuar në procesin e paqes, sidomos kur negociatat nën udhëheqjen amerikane kanë dështuar (Trenin, 2018). Për shembull, në vitin 2020, Rusia i ftoi përfaqësuesit e Hamasit dhe Fatahut në Moskë për të diskutuar mundësinë e një pajtimi kombëtar palestinez, çka tregoi për rolin e saj si faktor unifikues në politikën palestineze, përtej fragmentimit të brendshëm. Megjithatë, ky ndërmjetësim nuk ka prodhuar ndonjë rezultat të prekshëm në terren, për shkak të mungesës së një fuqie reale presioni nga ana e Ruisë, si dhe për shkak të kufizimeve të saj ekonomike dhe diplomatike në krahasim me SHBA-të. Nga ana tjetër, Rusia nuk e ka përqafuar në mënyrë aktive strategjinë e sanksioneve ndaj Izraelit, madje ka thelluar marrëdhëniet me të në fushën e teknologjisë dhe sigurisë, gjë që rrit dyshimet mbi neutralitetin e saj të deklaruar (Katz, 2018).

Në kushtet e një rendi ndërkombëtar gjithnjë e më të polarizuar, sidomos pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia në vitin 2022 dhe pas rritjes së tensioneve me Perëndimin, Moska ka intensifikuar përpjekjet për të ndërtuar aleanca strategjike në pjesë të ndryshme të botës, përfshirë Lindjen e Mesme. Për Rusinë, pozicionimi në çështjen palestinezo-izraelite ka edhe një vlerë simbolike: ai i mundëson të shfaqet si mbrojtëse e parimeve të sovranitetit dhe barazisë ndërkombëtare, në kontrast me atë që e konsideron si "hipokrizi perëndimore" dhe përdorim selektiv të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Rusia e ka dënuar publikisht përdorimin disproporcional të forcës nga Izraeli në Gaza, ka kërkuar armëpushime të menjëhershme në valët e fundit të dhunës dhe ka bërë thirrje për respektimin e të drejtave të palestinezëve. Zyrtarët rusë kanë theksuar vazhdimisht se zgjidhja e vetme e qëndrueshme është krijimi i një shteti palestinez në kufijtë e vitit 1967, me Jerusalemin Lindor si kryeqytet. Megjithatë, kjo retorikë nuk është shoqëruar me ndonjë presion real ndaj Izraelit, gjë që e kufizon rolin e Ruisë në sferën e ndikimit moral dhe diplomatik, pa peshë reale mbi zhvillimet konkrete.

Një element që e veçon Rusinë nga shumica e fuqive perëndimore është politika e saj e hapur për të komunikuar me të gjitha palët në konflikt, përfshirë edhe Hamasin – i cilësuar si organizatë terroriste nga BE dhe SHBA. Rusia nuk e ka futur Hamasin në listën e saj të organizatave terroriste dhe ka pritur përfaqësues të këtij grupi në takime zyrtare në Moskë. Kjo qasje i ka sjellë kritika të ashpra nga Perëndimi dhe nga Izraeli, të cilat e akuzojnë Rusinë për legjitimim të dhunës dhe minimin e përpjekjeve për një paqe të bazuar në mjete paqësore. Nga ana tjetër, Rusia e justifikon këtë qasje si një strategji realiste për të mbajtur kanale të hapura komunikimi me të gjithë aktorët relevantë dhe për të promovuar stabilitet në një rajon ku politikat përjashtuese kanë dështuar. Kjo politikë përfshirjeje është në përputhje me filozofinë e saj të përgjithshme në diplomacinë rajonale, ku përpjekjet të luajë rolin e një arbitri të balancuar dhe të besueshëm.

Përfundimisht, roli i Ruisë në konfliktin Palestinë–Izrael përfaqëson një kombinim të aspiratave për ndikim ndërkombëtar, trashëgimisë historike nga epoka sovjetike dhe kalkulimeve pragmatike strategjike. Moska pozicionohet si aktor alternativ ndaj dominimit perëndimor, me një diskurs të fortë për të drejtat e palestinezëve dhe për zgjidhjen me dy shtete. Megjithatë, ndikimi real i Ruisë në këtë konflikt mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së presionit politik, burimeve të kufizuara ekonomike dhe sfidave të brendshme dhe ndërkombëtare me të cilat përballet. Ajo që e dallon Rusinë është fleksibiliteti diplomatik dhe aftësia për të ruajtur marrëdhënie me të dyja palët, çka mund të shërbejë si aset në të ardhmen, nëse një konstelacion i ri ndërkombëtar e lejon atë të luajë rol më aktiv në procesin e paqes në Lindjen e Mesme.

#### **2.4 KOMBET E BASHKUARA – LEGJITIMITETI SIMBOLIK DE KUFIZIMET STRUKTURE**

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) përfaqëson kulmin e përpjekjeve ndërkombëtare për ruajtjen e paqes dhe sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve. Në çështjen e Lindjes së Mesme dhe veçanërisht konfliktit izraelito-palëstinez, OKB ka luajtur një rol kyç në përcaktimin e kornizave ligjore, miratimin e rezolutave dhe ndërmjetësimin diplomatik. Megjithatë, ndërsa OKB gëzon një **legjitimitet simbolik të fuqishëm**, efektiviteti i saj në zgjidhjen e këtij konflikti është i kufizuar nga faktorë të ndryshëm strukturore dhe politikë (Claude, 2006). Që nga miratimi i Rezolutës 181 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 1947, e cila propozonte ndarjen e Palestinës në dy shtete, deri te Rezoluta 242 e Këshillit të Sigurimit në 1967, OKB ka vendosur baza ligjore dhe normative për zgjidhjen e konfliktit (United Nations, 1947; United Nations Security Council, 1967). Këto rezoluta kanë formësuar kornizën e negociatave dhe kërkesave ndërkombëtare për respektimin e sovranitetit, të drejtave të refugjatëve dhe tërheqjen izraelite nga territoret e pushtuara. Mirëpo, shpesh ndodh që këto rezoluta të bllokohen dhe shkak kryesor është vetë struktura politike e OKB-së veçanërisht fuqia e vetos që zotërojnë pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit (SHBA, Rusia, Kina, Britania e Madhe dhe Franca). Në fakt rezolutat bllokohen ose komprometohen për shkak të interesave gjeopolitike të këtyre fuqive. Veçanërisht, SHBA kanë përdorur shpesh veton për të mbrojtur Izraelin nga rezoluta që dënojnë veprimet ushtarake apo zgjerimet e paligjshme në territoret e pushtuara, duke e dobësuar kështu efektivitetin e OKB-së si mekanizëm ligjor dhe politik për zgjidhjen e konfliktit

(Lynch, 2013). Pavarësisht këtyre kufizimeve, OKB vazhdon të ofrojë një platformë të rëndësishme diplomatike dhe një mjet për presion moral dhe politik. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme dhe komisionet e posaçme vazhdojnë të mobilizojnë opinionin ndërkombëtar dhe të mbajnë çështjen palestineze në agjendën globale (Falk, 2014). Gjithashtu, organizata ofron mbështetje për ndihmën humanitare dhe ndërtimin e institucioneve, si dhe koordinon misionet paqeruajtëse dhe aktivitetet monitoruese.

Për ta bërë OKB më efektive dhe më të barabartë në trajtimin e konflikteve është nevoja për **reformimin e OKB-së**, veçanërisht Këshillit të Sigurimit. Pa këto reforma, OKB rrezikon të mbetet një mekanizëm me legjitimitet simbolik të fuqishëm, por me **impotencë operative** në zgjidhjen e konflikteve ku interesat e fuqive të mëdha janë të kundërta. Ky hendek midis legjitimitetit dhe efektivitetit kufizon fuqinë e OKB-së për të qenë një faktor vendimtar në drejtimin e paqes në Lindjen e Mesme, duke e bërë të nevojshme një reflektim serioz mbi reformën dhe fuqizimin e mekanizmave ndërkombëtarë për të përballuar sfidat e sotme.

## 2.5 SHTETET ARABE: RETORIKA E SOLIDARITETIT DHE REALPOLITIKË

Që prej krijimit të shtetit të Izraelit më 1948 dhe shpërthimit të krizës palestineze, shtetet arabe kanë ndërtuar një narrativë të fortë të **solidaritit me kauzën palestineze**. Gjatë dekadave, ky solidaritet është shprehur në samite të Ligës Arabe, deklarata publike, ndihmë humanitare dhe në disa raste përmes ndërhyrjeve politike ose ushtarake. Megjithatë, një analizë më e thellë e sjelljes së shumë shteteve arabe tregon një **hendek të thellë mes retorikës së solidaritetit dhe praktikës së realpolitikës**, ku interesat strategjike kombëtare, lidhjet me fuqitë perëndimore dhe frika nga destabilizimi rajonal shpesh kanë dominuar ndaj angazhimeve të sinqerta ndaj çështjes palestineze.

Në çdo krizë të madhe në Palestinë – që nga **lufta e vitit 1967**, intifadat palestineze, deri tek ofensivat izraelite në Gaza – shtetet arabe janë rreshtuar me fjalë në mbështetje të popullit palestinez. Samitet e Ligës Arabe janë mbushur me deklarata të forta kundër Izraelit dhe thirrje për "veprim të përbashkët". Për shembull, në **Samitin e Bejrutit (2002)**, shtetet arabe miratuan iniciativën paqësore arabe, e cila ofronte njohjen e plotë të Izraelit në këmbim të tërheqjes në kufijtë e vitit 1967 dhe krijimit të një shteti palestinez me Jerusalemin Lindor si kryeqytet. Megjithatë, kjo iniciativë kurrë nuk u ndoq me presion real ndaj Izraelit, as me mekanizma detyrues (Gause, 2019). Nga ana tjetër shumë shtete arabe, veçanërisht ato të **Gjirit Persik** si Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahreini, i kanë orientuar politikat e tyre të jashtme në përputhje me interesat strategjike të mbretërive dhe elitave sunduese. Këto interesa përfshijnë:

- **Koordinimin me SHBA-në** si garantues sigurie ndaj kërcënimit iranian.
- **Stabilitetin e brendshëm**, për të shmangur ndikimet e mundshme të grupeve islamike si Hamas.
- **Integrimin ekonomik dhe teknologjik me Perëndimin dhe Izraelin**, veçanërisht pas Marrëveshjeve të Abrahamit (Lynch, 2020).

Ky realitet i politikës rajonale bëhet i dukshëm me **normalizimin e marrëdhënieve të disa shteteve arabe me Izraelin**, pa ndonjë përparim të dukshëm në drejtim të të drejtave palestineze. **Marrëveshjet e Abrahamit të vitit 2020**, të ndërmjetësuara nga SHBA, i dhanë Izraelit njohje nga Emiratet, Bahreini, Sudani dhe Maroku – me shumë pak përfitime për Palestinën. "Arabët janë lodhur nga çështja palestineze", tha një diplomat nga një vend i Gjirit në një intervistë konfidenciale, "dhe lidhshëritet e tyre janë më të interesuara për stabilitetin rajonal dhe partneritetet me fuqitë ekonomike sesa për zgjidhjen e konfliktit palestinez" (Al-Rasheed, 2022).

## 3. POLITIKA E STANDARDEVE TË DYFISHTA DHE HESHTJA

Një ndër elementët më të diskutueshëm në konfliktin izraelito-palëstinez është qasja selektive e Perëndimit ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare. Politika e standardeve të dyfishta shfaqet në mënyrën se si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe aleatë të tjerë reagojnë në situata të ndryshme ndërkombëtare, përfshirë Ukrainën, por tregojnë një tolerancë të theksuar kur bëhet fjalë për veprimet e Izraelit ndaj popullit palestinez. Qëndrimet e përsëritura për "të drejtën e Izraelit për vetëmbrojtje" janë shndërruar në një justifikim të heshtur për operacione ushtarake disproporcionale, të cilat shpesh kanë shkaktuar viktima të shumta civile dhe shkatërrim të infrastrukturës në Rripin e Gazës. Në kontrast, reagimi i shpejtë dhe sanksionet e ashpra ndaj agresionit rus në Ukrainë e zbulojnë hipokrizinë e mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare.

Shembuj konkretë përfshijnë vendimin e administratës amerikane për të bllokuar disa rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që dënonin bombardimet izraelite në Gaza, si dhe dështimin e BE-së për të aplikuar masa ndëshkuese ndaj Izraelit në përputhje me shkeljet e përsëritura të të drejtave të njeriut (B'Tselem, 2022).

Kjo qasje selektive minon legjitimitetin e normave ndërkombëtare dhe krijon një precedent të rrezikshëm për mbështetjen e rendit liberal ndërkombëtar vetëm kur është në përputhje me interesat strategjike të fuqive perëndimore. Mospërputhja në reagim dhe mungesa e presionit diplomatik serioz ndaj Izraelit ka kontribuar në ruajtjen e status quo-së dhe ka pamundësuar përpjekjet për një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme. Për më tepër, kjo politikë e dyfishtë ka krijuar zhgënjim të thellë në mesin e popullsisë arabe dhe myslimane, duke minuar përpjekjet për bashkëpunim ndërkulturor dhe duke ushqyer ndjenjat anti-perëndimore. Kjo situatë përbën një sfidë jo

vetëm për paqen në Lindjen e Mesme, por edhe për legjitimitetin moral dhe koherencën e politikës së jashtme të vetë aktorëve perëndimorë.

#### 4. KONKLUZË

Analiza e konfliktit Palestinë-Izrael përmes prizmit të rolit të aktorëve ndërkombëtarë nxjerr në pah një realitet të hidhur: paqja në Lindjen e Mesme nuk është thjesht çështje e vullnetit lokal, por pasqyrë e një arkitekture ndërkombëtare thellësisht të politizuar dhe të pabarabartë. Nga Shtetet e Bashkuara si një ndërmjetës i vetëshpallur, por thellësisht i njëanshëm; te Bashkimi Evropian që vepron më shumë si donator humanitar sesa si forcë politike; te Rusia që luan me retorikën pro-palestineze por pa mekanizma presioni real; dhe deri te Kombet e Bashkuara që, ndonëse legjitime simbolikisht, janë të paralizuar nga struktura e tyre – të gjitha këto aktorë ndërkombëtarë dështojnë të ofrojnë një rrugë të drejtë dhe të qëndrueshme drejt paqes.

Përtej deklaratave të zbrazëta për zgjidhje me dy shtete dhe mbështetje për të drejtën ndërkombëtare, ndërhyrjet ndërkombëtare karakterizohen nga standarde të dyfishta, qasje selektive dhe shpeshherë instrumentalizim i vuajtjes së popullit palestinez për interesa më të gjera gjeopolitike. Dështimi për të zbatuar rezolutat e OKB-së, heshtja përballë krimeve të luftës dhe mungesa e presionit real mbi politikën izraelite të okupimit, janë dëshmi e thellë e krizës së rendit ndërkombëtar. Konflikti Palestinë-Izrael, në këtë kuptim, nuk është thjesht një çështje rajonale, por simptomë e një sistemi ndërkombëtar në kolaps normativ dhe moral.

Në këtë kontekst, reforma e mekanizmave ndërkombëtarë të paqes dhe sigurisë paraqitet si një domosdoshmëri urgjente. Pa një qasje të re, të bazuar mbi parimin e barazisë sovrane, respektimin e të drejtave njerëzore dhe të drejtës për vetëvendosje, çdo përpjekje për paqe do të mbetet e destinuar të dështojë. Është koha që Bashkësia Ndërkombëtare të kalojë nga retorika në veprim, nga balancat strategjike në drejtësi reale – përndryshe, historia do të vazhdojë të përsëritet në cikle dhune, padrejtësie dhe pasigurie globale.

#### REFERENCA

- Al-Rasheed, M. (2022). *The Arab States and the Palestinian Cause: Between Rhetoric and Interests*. London: Hurst Publishers.
- B'Tselem. (2022). *Israel's apartheid regime: Cruel system of domination and crime against humanity*. <https://www.btselem.org/>.
- Brown, N. J. (2021). *When Rhetoric Replaces Strategy: Arab Responses to Palestine*. Carnegie Endowment for International Peace. <https://carnegieendowment.org>.
- Claude, I. L. (2006). *Swords into Plowshares: The Problems and Progress of International Organization*. Random House.
- European Commission. (2024). *EU Support to the Palestinian People*. <https://ec.europa.eu/>.
- Falk, R. (2014). *Palestine and the United Nations: A Journey of Liberation*. Routledge.
- Gause, F. G. (2019). *The International Relations of the Persian Gulf*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Golan, G. (1990). *Soviet Policies in the Middle East: From World War Two to Gorbachev*. Cambridge University Press.
- Katz, M. N. (2018). *Russia and the Middle East: The View from Washington*. Middle East Policy Council.
- Kozhanov, N. (2016). *Moscow's Strategy in the Middle East: Motivations and Methods*. Chatham House.
- Krasner, S. D. (2023). *The Double Standards of International Order: Ukraine, Palestine, and Global Norms*. International Affairs Journal, 99(2).
- Lynch, M. (2020). *The New Arab Order: Power and Violence in Today's Middle East*. Columbia University Press.
- Pappé, I. (2021). *Ten Myths About Israel*. Verso Books.
- Sharp, J. M. (2021). *U.S. Foreign Aid to Israel*. Congressional Research Service. <https://crsreports.congress.gov/product/pdf/RL/RL33222>.
- Trenin, D. (2018). *What Is Russia Up to in the Middle East?* Polity Press.
- United Nations Security Council. (1967). Resolution 242. [https://undocs.org/S/RES/242\(1967\)](https://undocs.org/S/RES/242(1967)).
- United Nations. (1947). Resolution 181 (Partition Plan). [https://undocs.org/A/RES/181\(II\)](https://undocs.org/A/RES/181(II)).